

Konsultime me komunitetin lokal mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së

Zhepçë, Bosnjë e Hercegovinë

28. prill 2010.

Shoqata e gazetarëve të BeH-së dhe shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit të Kroacisë, organizuan konsultimet me komunitetin lokal, në të cilin morën pjesë 37 përfaqësues të viktimave (posaçërisht të të burgosurve të kampeve të përqendrimit), organizatave joqeveritare, politikanë, përfaqësues të autoriteteve lokale, të kantoneve dhe federatave, si dhe gazetarë. Fjalën hyrëse e mbajtën Borka Rudić, sekretare e shoqatës së *Gazetarët e BeH*, (Sarajevë, BeH), dhe Sudbin Musić (Shoqata Prijedor '92) dhe anëtarë i Koalicionit të KOMRA-së.

Shqyrtimet e propozimeve, opinioneve dhe rekomandimeve të pjesëmarrësve/eve

KOMRA duhet tu ofrojë ndihmën psiko-sociale edhe meshkujve si viktimë të luftës, e jo vetëm femrave.

... ekzistojnë shumë shoqata të grave: Gratë për gratë, Gratë viktimë të luftës... Ndërsa ne meshkujt jemi më pak të mbrojtur, me të vërtetë. Edhe neve na duhet ndihma psiko-sociale, na nevojiten lloje të ndryshme të ndihmës. Mendoj se në qëllimet e saj, KOMRA duhet ta parasheh edhe ndihmën psiko-sociale (për meshkujt) si viktimë të luftës. (Muriz Arapović, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit, Vares, BeH, Konsultime me komunitetin lokal mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Zhepçë, 28 prill 2010)

KOMRA duhet t'u ndihmojë të gjithëve, posaçërisht të burgosurve të kampeve të përqendrimit, që të sigurojnë të drejtën e tyre në kompensimin e pronës dhe të drejtave sociale.

Edhe ne po tentojmë përmes këtij Koalicioni, i cili do të formohet, të bëhen të ditura të gjitha, - posaçërisht ne, të burgosurit e kampeve të përqendrimit. Për ne, nuk ka asgjë të shkruar lidhur me të drejtën tonë për sigurimin e të drejtave tona, ndërsa për pronën e shkatërruar as që bëhet fjalë. Derisa ne ishim të burgosur në kampe të përqendrimit, e tërë pasuria ime është

shkatërruar! Janë bërë dhjetë vite që jam kthyer, dhe nuk kam marrë asnjë para për rindërtimin e shtëpisë sime, e as të pronës sime. (Zahid Kremlić, Shoqata e qytetarëve të kthyer në komunën e Dobojit, dhe anëtar i Shoqatës së të burgosurve të kampeve të përqendrimit të kantonit Zenicë-Doboj, BeH, Konsultime me komunitetin lokal mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Zhepçë, 28 prill 2010)

Shoqata Fuqia e gruas nga Zenica, ka përvojë në punën me gratë-viktima. Këtë përvojë ne do t'ia vëmë në dispozicion KOMRA-së.

Ne, si Shoqatë, Fuqia e gruas nga Zenica, në qëllimet tona e kemi edhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. (...) Qëllimet të cilat sot, ju i prezantuat këtu, në plotësi përputhen me qëllimet tona, të cilat i kemi në statutin tonë, dhe e mbështesim plotësisht Iniciativën për themelimin e komisionit Rajonal. Në radhët e anëtarëve tonë, kemi gra të cilat kanë qenë viktima të dhunës, kemi persona të cilët akoma nuk i kanë gjetur të afërmit e tyre. Kështu që, në shoqatën tonë kemi pasë rast t'u ofrojmë ndihmë psiko-sociale grave, bashkëshortët e të cilave akoma nuk janë gjetur, të cilat kanë qenë të lëna në mëshirë të vetë-vetes, nuk kanë pasë kurrfarë kujdesi nga shoqëria. Pra, do të kyçemi në mënyrë aktive në ndihmën dhe punën e KOMRA-së. (Sabiha Kurtić, kryetare e Shoqatës Fuqia e gruas nga Zenica, BeH, Konsultime me komunitetin lokal mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Zhepçë, 28 prill 2010)

Komisioni duhet të vërtetojë se kush është viktimë, e kush është i burgosur i kampeve të përqendrimit. Duhet të sigurohet paraqitja mediale e rrëfimit të viktimave, pa te nuk ka asgjë.

Së pari, duhet të definohet se kush është viktimë, e kush janë të burgosur të kampeve të përqendrimit. (...) A mund ti konsiderojmë viktimë edhe anëtarët e familjeve, të cilat e kanë humbur ndonjë anëtarë, që ka qenë ushtar, gjatë aktiviteteve ushtarake? Ju lutem të kemi kujdes, se a ka luftuar ai sipas urdhërit për mobilizim (pavarësisht në cilën ushtri), dhe ka humbur jetën. A janë, sot, ato familje viktima në kuptimin e krimeve të luftës apo jo? (...) këtyre nga shoqatat e ndryshme, u propozoj që të tentojnë të bëjnë dallimin mes luftës për status shoqërorë nga e drejta për të kuptuar të vërtetën lidhur me vuajtjen e ndokujt, lidhur me atë se ai është viktimë. Të mos flasim tani për atë, se a ka ai ndihmë apo jo, a merr ai ndihmë apo jo për shkak se është viktimë. Kjo do të vijë në radhë, kur të vërtetohet e vërteta. (...)

Unë nuk i frikësohem hulumtimit të shkakut të luftës, (...) në fund të fundit, duhet kthyer prapa, në periudhën e gjeneratave të indoktrinuara të cilat janë rritur dhe kanë pritur vitin '91, si të aftë për ushtri... Të identifikohet kjo dhe të eliminohen preferencat ideologjike, të cilat kanë indoktrinuuar gjithandej. (...) Interpretimi medial i burgosjeve, krimeve etj, është shumë i rëndësishëm. Krejt çfarë do të bëjë KOMRA, duhet të jetë edhe në media, kur të fillojnë rrëfimet e viktimave, dhe KOMRA do të pranohet (shpresoj se po) nga ana e institucioneve shtetërore.

Duhet ta thotë dikush, se pa këtë s'ka asgjë. Në kuptim thelbësorë, gjatë shtatë ditëve, aq sa është paraparë koha për deklaratat e viktimave, të sigurohemi se opinioni do të dëgjojë atë çfarë e rrëfejnë ata. (...)Po që se nuk do të prezantohen edhe përmes mediave dhe nuk do të bëhet presion në qeveritë përkatëse, atëherë për personat e rinj kjo do të jetë e mërzitshme (për gjeneratat që janë lindur pas luftës). (Idriz Alihodžić, Konsultime me komunitetin lokal mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Zhepçë, 28 prill 2010)

KOMRA rikthen autoritetin dhe respektimin e marrëdhënieve ndër-fqinjësore mes popujve.

Pse i jam bashkangjitur KOMRA-së? Për shkak të një arsyeje mjaft të thjeshtë, sepse e kam kuptuar se kjo është një fuqi e lëvizjes, e cila do të rikthej autoritetin dhe respektin, marrëdhëniet e mira ndër-fqinjësore mes popujve në vendin tim. (Zlatko Prkić, Kryesia e Shoqatës së të burgosurve të kampeve të përqendrimit, nga lufta kombëtare e BeH, Varesh, BeH, Konsultime me komunitetin lokal mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Zhepçë, 28 prill 2010)

Çfarë duhet të bëjmë që t'u ndihmojmë njerëzve të cilët kanë vuajtur në luftë, dhe të drejtat e të cilëve akoma shkelen?

...desha të them diçka për KOMRA-në dhe të pyes: çfarë duhet të bëjmë ne, si t'u ndihmojmë njerëzve të cilët kanë vuajtur në luftë. Strukturat ekzistuese shtetërore, nuk kanë bërë shumë për ta. Në të vërtetë, ne të gjithë kemi vuajtur, në luftë dhe gjatë luftës, dikush më shumë e dikush më pak. Thjesht, më intereson, se a mund të formohet në ndonjë mënyrë një shoqatë e të burgosurve të kampeve të përqendrimit, të mos ketë një shoqatë të Kroacisë, pastaj një të Bosnjës, e tjetra në Serbi, dhe nuk po dihet më se kush është nga cili vend... të shohim dhe të bëjmë të gjithë një të vetme, t'i qasemi punës dhe t'ua bëjmë me dije njerëzve, ndaj të cilëve akoma po bëhen shkelje të të drejtave të njeriut, dhe tu themi se kjo gjë duhet të ndërpritet. (Ruža Vlajković, Shoqata e grave, në Teshnje, BeH, Konsultime me komunitetin lokal mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Zhepçë, 28 prill 2010)

Kam frikë se po fillojmë me ide të mira, pastaj me qëllime dhe të pritura të pa definuara, dhe po humbemi. E pastaj lajmërohen edhe probleme të vogla dhe interesa tjera.

Kam informata të caktuara për KOMRA-në, se disa organizata po hynë dhe po dalin, akuza se po punohet kështu apo ashtu, dhe nga ky aspekt, që si organizatë të kemi më shumë kujdes lidhur me qasjen në këtë Iniciativë, edhe pse me të vërtetë, në emrin tim dhe në emrin e organizatës, mund të them se këtu kam vërejt ide shumë të mira. Kam frikën se ne ndonjëherë fillojmë me ide të mira, e pastaj me qëllime dhe të pritura të pa definuara, dhe diku po humbemi, e pastaj

këtu lajmërohen problemet e vogla dhe interesat e ndryshme, dhe ideja dështon para se të fillojë të zhvillohet. Kjo është diçka që unë e them me kujdes, dhe ne do të mendojmë dhe do të flasim në organizatën tonë, se a duam të bashkangjitemi dhe në çfarë mënyre duam të bëhemi anëtarë aktiv në gjithë këto ngjarje. (Maksuma Topalović, organizata joqeveritare Alternativa, Kakanj, BeH, Konsultime me komunitetin lokal mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Zhepçë, 28 prill 2010)

Vërtetimi i fakteve (shtetërore) për krimet e luftës ecë shumë ngadalë. Për këtë arsye, të burgosurit e kampeve të përqendrimit të Zenicës e mbështesin themelimin e KOMRA-së.

Në kuadër të Këshillit veprojnë tetë shoqata, dhe ne pas konsultimeve të para, kemi konkluduar se Koalicioni për KOMRA, do të ishte faktori i cili do të mund të shkojë drejt vërtetimit të fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të të drejtave të njeriut. (...) dhe kemi vendosë që të marrim pjesë në punën e Koalicionit për themelimin e KOMRA-së. Ky është vendimi i Bordit Drejtues të Këshillit të të burgosurve të kampeve të përqendrimit të kantonit Zenicë – Doboju. Kjo do të thotë – se këshilli i mbledh viktimat e torturave: të burgosurit ushtarak të luftës – të burgosurit e kampeve të përqendrimit dhe civilët - të burgosurit e kampeve të përqendrimit. Dhe kur është fjala për vërtetimin e fakteve të krimeve të luftës, kjo çështje ecë shumë ngadalë dhe vështirë, e një nga arsyet është edhe kjo që po e thonë kolegët – zhduken biologjikisht apo ndryshojnë mendjen e tyre, kur shohim marrëdhënien mes shtetit dhe ligjit ndaj tyre, andaj heqin dorë. (Šaban Ibrahimović, Kryetar i Këshillit të burgosurve të kampeve të përqendrimit, në Zhepçe, kantoni i Doboju, Zenicë, BeH, Konsultime me komunitetin lokal mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Zhepçë, 28 prill 2010)